



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Bashkia Tiranë
Adresa Sheshi “Skënderbej”, Tiranë
Tel/Fax 0035542256799
E-mail marisa.kacori@tirana.al
Adresa e Internetit www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 4 (katër) bileta udhëtimi vajtje-ardhje, për Pragë, Çeki”**.

Data e zhvillimit do të jetë **09.09.2019 ora 14.30** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit), si më poshtë:

a) 1 biletë me të dhënat:

- Itinerari: Tiranë-Pragë-Tiranë.
- Nisja më datë 11.09.2019 herët në mëngjes.
- Kthimi më datë 12.09.2019 pasdite.
- Fluturim direkt / nje ndalese / bagazhe të përfshira.

b) 3 (tre) bileta, me të dhënat:

- Itinerari: Tiranë-Pragë-Tiranë.
- Nisja më datë 11.09.2019 në mëngjes.
- Kthimi më datë 13.09.2019 në darkë.
- Fluturim me nje ndalese / bagazhe të përfshira.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet

sistemit te prokurimit elektronik, *Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.*

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të njoftoj Autoritetin Kontraktor për realizimin /mosrealizimin e objektit të prokurimit, brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit në sistem, në të kundërt operatori do të s'kualifikohet duke përzgjedhur ofertuesin ekonomik i renditur i dyti në listën e ofertave që kanë mbetur, deri në ofertuesin e renditur në vend të fundit.

Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë menjëherë (elektronikisht) duke filluar nga momenti i shpalljes së fituesit.

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.